



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Kodin e punës së KEK Sha, si dhe në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Financiar të KEK-ut dhe në Kabinetin e KE, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 05.09.2024 që të publikojë ofertën për pozitën e mëposhtme:

KONKURS

Titulli i pozitës:1.	<u>Menaxher/e thesari</u>
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës (Divizionin Financiar)
Numri i referencës:	07-05.09.2024
Tipi Akt Emërimin të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA01/2024
Titulli i mbikëqyrësit	I raporton Drejtorit Financiar
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	1440 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	1
Vendi i punës:	Prishtine

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës menaxhon parandë dhe gatshme dhe veprimet bankare. Parashikon dhe analizon e qarkullimin e parasë së gatshme. Monitoron dhe përcjellë dërgimin e transaksioneve bankare me kohë në llogarinë rrjedhëse të kompanisë. Planifikon nevojat për para të gatshme. Procedon urdhër pagesat.

Transferet interne, Depozitimim e Fondeve, Arkat për nevoja të brendshme të kompanisë, Kontrollin llogaritar, Rikonsilimin e gjendjes bankare me atë të kontabilitetit. Përpunon raporti bankar. Mbanë marrëdhëniet me banka.

Benë hulumtimin e tregjeve ndërkombëtare dhe kombëtare të letrave me vlerë. Financimin afatshkurtër / tregu i parasë, Financimin afatgjatë / tregu i kapitalit. Krijimin e një organizimi efikas dhe të përkushtuar të njësisë së Thesarit ku performanca e punëtorëve do të maksimizohet. Bashkëpunon me divizionet tjera për menaxhimin më të mirë të rrjedhës së parasë.

Si dhe Detyra, caqe dhe projekte tjera që i caktohen kohë pas kohe

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Kualifikim Universitar Magjistër në Banka dhe Financa, Kontabilitet apo Administrim Biznesi.

Përvojë në modelime financiare dhe Përvojë në analiza financiare për investime

Përvojë Menxheriale në fushën financiare 3 vite, të dëshmuara me kontrata të punës dhe me pasqyrën e trustit pensional

Njohje të mirë të gjuhës angleze (folur & të shkruar)

Njohje të mirë të programeve kompjuterike, Office 365 në veçanti Excel

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: "Ngarko Aplikacionin e plotësuar"
- Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit dhe të masterit , përvojën e punës të dëshmuara me kontratën e punës dhe me pasqyrën e trustit pensional** (i skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza "Ngarko dëshmitë e kualifikimit". Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

